

Kombetarja/ Kuzhe kerkon revolucion kuqezi

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 07 Shtator 2011 22:34



Nje dite pas humbjes se turpshme kunder Luksenburgut delegacioni kuqezi eshte kthyer ne Shqiperi. Trajneri Josip Kuzhe nuk ka permendur per asnje cast fjalen doreheqje nderkohe qe po mendon per te bere revolucionin qe kerkohet prej kohesh ne perfaquesuese. I pyetur per kete Kuzhe ka pranuar se duhet rinostrar skuadra per eleminatoret e ardhshme por pa permendur emrat qe duhen larguar apo afruar. "Ne menyre te menjehershme duhet te fillojme nga fillimi. Duhet te grumbullojme lojtare te rinj dhe formojme nje kombetare te re. Na duhet te provojme gjera te reja pas eksperencies ne kete eleminatore. Kerkohet revolucion por me levizje te matura", theksoi Kuzhe.